

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBAVENTURES DMC”

Shoqëria tregtare “ALBAVENTURES DMC” sh.p.k. është krijuar nga ortakët:
Gëzim Berisha, Natasa Spiric Smiljanic, Mirko Smiljanic.

KREU I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
(forma, emërtimi, objekti, vula, logo, selia kohëzgjatja)

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i shoqërisë do të jetë: “Albaventures DMC”.

NENI 2
FORMA

Shoqëria tregtare “Albaventures DMC” do të jetë person juridik në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).
Fitimi i personalitetit juridik fillon pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB).

NENI 3
LOGO, VULA

Logo dhe vula e shoqërisë do të përcaktohet nga ortakët.

NENI 4
OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- “Albaventures DMC” sh.p.k. është një shoqëri që ka aktivitet organizim konferencash, seminaresh, transferta, eskursione;
- Operimi në fushën e turizmit, hotelerisë, shoqërim turistesh vendas dhe të huaj, udhëtime pune etj;



H.S.

1


- Organizim, shitje / blerje të paketave turistike;
- Rezervime apartamentesh dhe hotelesh;
- Udhëtime Turistike me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
- Organizim turesh brenda dhe jashtë vendit. Pushime dhe udhëtime me kroçëra.
- Shoqëria bashkëpunon me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh etj, vendase dhe/apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje etj, që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë.

NENI 5 SELIA

Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Rr. Xhemal Tafaj Nd.32, Tiranë.
Shoqëria mund të hapë agjensi dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Shoqëria e kryen aktivitetin e saj në të gjithë Shqipërinë.

NENI 6 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

KREU I II KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 7 KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100,000 lekë dhe është i ndare në tre kuota respektivisht:

Ortaku Gëzim Berisha me nr pasaporte BC3024886 zotëron 1 kuote me vlere 50% të kapitalit themeltar me vlere 50.000 Leke (pesedhjetë mijë).

Ortaku Natasa Spiric Smiljanic me nr pasaporte 17CE00262 zotëron 1 kuote me vlere 25% të kapitalit themeltar me vlere 25.000 Leke (njetzet e pese mijë).

Ortaku Mirko Smiljanic me nr pasaporte 16AF48872 zotëron 1 kuote me vlere 25% të kapitalit themeltar me vlere 25.000 Leke (njetzet e pese mijë).

M.S.

NENI 8
KAPITALI THEMELTAR

Pjesët e kapitalit themeltar janë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht nga ortakët. Pjesët e kapitalit themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para, në matyrë por asnjëherë kontribute në shërbime. Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë, ato vlerësohen me konsensus nga ortakët.

NENI 9
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin themeltar. Për çdo rast të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit themeltar, nuk duhet të ndryshojë përqindja e tij.

NENI 10
TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek ortakët. Gjithashtu ato si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:


1. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
2. Shitblerjes;
3. Dhurimit;
4. Trashëgimisë;
5. Dhe në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

KREU I III
ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 11
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mbledhet në mbledhje të zakonshme që kanë të bëjnë me shqyrtimin e çështjeve të zakonshme të shoqërisë si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me çështje emergjente. Vendimet meren në unanimitet nga të dy ortakët e shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligj.



M.S

3


NENI 12 ADMINISTRIMI

1. Me vendim të Asamblesë të Ortakëve, Administrator i shoqërisë emërohet **Gëzim Berisha** me një mandat prej 5 vitesh.
2. Administratori ka këto kompetenca:
 - Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregare të shoqërisë në përputhje me politikat e vendosura nga ortakët.
 - Përfaqëson shoqërinë si në administratën publike ashtu edhe tek të tretët.
 - Përgatit, ruan dhe administron të gjithë dokumentacionin e shoqërisë.
 - Cel llogari bankare në emër të shoqërisë dhe kryen veprime bankare si depozitim parash, transferta parash, tërheqje parash, pagesa të ndryshme etj.
 - Të gjitha kompetencat e tjera të parashikuara në ligj.
3. Administratori shpërblehet me pagë mujore që vendoset nga Asambleja e Ortakëve.
4. Mandati i administratorit është 5 vjet me të drejtë riemërimi.
5. Administrator mund të jetë një nga ortakët ose cdo person tjetër.
6. Administratori emërohet/shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve.

KREU I IV

FUNKSIONI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM, KONTABILITETI, PASQYRAT FINANCIARE


NENI 13 KONTABILITETI

Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm nëpërmjet një eksperti kontabël të miratuar, i cili mban kontabilitetin, përgatit pasqyrat financiare dhe cdo veprim tjetër që mund të kryejë kontabilisti në shoqëri, sipas ligjit.

Ai përgjigjet për cdo dëm që mund të vijë shoqërisë nga veprimet/mosveprimet e tij në kundërshtim me detyrën/ligjin.

NENI 14 PASQYRAT FINANCIARE

Viti financiar fillon në datën 1 Janar dhe mbyllet në datën 31 Dhjetor të cdo viti, me përjashtim të rasteve dhe urdhërave të vecanta të ortakëve. Në fund të cdo periudhe ushtrimore bëhet bilanci dhe nxirret rezultati financiar.



M.S

4
AB

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pasi bëhen detyrimet fiskale, fitimi i mbetur përdoret nga ortakët.

KREU IV

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË DHE DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 15 SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shoqëria mund të shpërbëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kur është dëshira e ortakëve, kur është në prag falimenti dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Për çdo rast Asambleja e Ortakëve vendos për mënyrën e likuidimit dhe emëron një ose disa likuidatorë.

NENI 16

DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

- Në rast se ka çështje që nuk rregullohen nga ky statut, apo nga marrëveshja e ortakëve, atëherë ato çështje rregullohen nga dispozitat e Ligjeve në fuqi.
- Ndryshimet në statut do të bëhen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Ky statut hyn në fuqi në datën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, pranë QKB-së.

Ky statut nenshkruhet prej ortakëve në datën 09/05/2024.

ORTAKU

GËZIM BERISHA

ORTAKU

NATASA SPIRIC SMILJANIC

ORTAKU

MIRKO SMILJANIC